



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë / /2022  
Nr. Dok. 202101682/2

**Lënda:** *Rekomandim lidhur me shmangien e përdorimit dhe emërtimit të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist.*

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
Tiranë

**Për dijjeni:** **AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI**  
**DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**  
Tiranë

**KRYETARIT TË BASHKISË**  
Tiranë

***Të nderuar!***

Institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjin 8454/1999, "Për Avokatin e Popullit", ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike apo personave të tretë të lidhur me të.

Për këtë arsye, gjatë punës tonë i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë edhe trajtimin të ankesave dhe problematikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë në forma të ndryshme gjatë regjimit komunist, apo tashmë edhe trashëgimtarëve të tyre të ligjshëm, të cilët në mjaft raste ende janë në kërkim të një varri, të një të drejte apo edhe kujtimi që lidhet me trashëgimlënësit e tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet të organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga disa shqetësime të ngritura në forume dhe tryeza ku ngrihen dhe diskutohen tashmë problematika që kanë lidhje me drejtësinë tranzitore dhe të drejtat që lidhen dhe personat e persekutuar gjatë regjimit komunist, në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, ka ndërmarrë me iniciativë shqyrtimin e çështjes së përdorimit dhe emërimit të rrugëve, sheshëve dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist.

Një shqetësim i tillë u parashtrua edhe nga një familje e ish- të përndjekurve në aktivitetin e organizuar nga AIDSSH, “Tirana në sytë e sigurimit”, si pjesë e aktiviteteve në kuadër të projektit studimor për persekutimin në kryeqytet. Sipas këtij shtetasi, ende sot në Bashkinë e Tiranës ka emërtime të lagjeve apo rrugëve që lidhen me data të lindjes të personazheve që i përkasin diktaturës komuniste.

Emërtimi i rrugëve, sheshëve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë është një kompetencë eskuzive e Këshillit Bashkiak, e parashikuar shprehimisht në nenin 54 pika 11 të Ligjit 139/2015 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Megjithatë, tashmë janë evidentuar raste të përdorimit, emërimit dhe shprehjes në deklarata dhe zhargonin e përditshëm të datave dhe simboleve që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist, të cilat në gjykimin dhe vlerësimin e personave të prekur drejtpërdrejtë nga regjimi komunist, apo edhe trashëgimtarëve të tyre, përbëjnë një zgjim të kujtimeve dhe situatave të rënda që kanë kaluar.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson faktin dhe mban qëndrimin se ndërtimi i një shoqërie të shëndoshë dhe pa mbetje të së shkuarës, që shkeli në mënyrë masive dhe të dhunshme të drejtat dhe liritë e njeriut është baza e një shteti të së drejtës. Në shtetet të cilat kanë kaluar konflikte, luftra, apo regjime diktatoriale, siç është rasti i Shqipërisë, të drejtat e njeriut dhe riparimi i tyre kthehet në fokusin kryesor të masave që merren si pjesë e implementimit të drejtësisë tranzitore.

Ndër pikat më të forta të një regjimi, siç ishte ai i kaluar komunist, ishte propaganda. Mendësia komuniste, e cila manifestohej nëpërmjet kësaj propagande, shoqërohej edhe me përdorimin e simboleve të caktuara, nderimin e emrave, të ditëve të lindjes ose të vdekjes të liderave komunistë, ngritjen e busteve të udhëheqësve të komunizmit etj.

Sot, shtetet post-komuniste kanë ndërmarrë apo vazhdojnë të zbatojnë masa të drejtësisë tranzitore që nisin fillimisht me njohjen e asaj që ka ndodhur. Njohja përbën vetëm një ndër hapat e shumtë, por është edhe fillesa e një përpjekje të madhe të shoqërisë post-komuniste për të riparuar vetveten. Pa njohje, nuk ka ndryshim. Pranimi i asaj që ka ndodhur, pason me nderimin e atyre që ju shkelën të drejtat dhe liritë, si dhe respektimin e tyre për atë që i bëri sistemi i kaluar. Duhet të theksojmë se kjo nuk përbën vetëm një mohim të këtyre të drejtave, por konsiston në cënimin e dhunshëm të tyre deri në marrjen e jetës. Për viktimat dhe/apo familjarët e tyre, njohja është procesi më i rëndësishëm, sepse u jep atyre një vend në shoqëri. Tashmë ata nuk janë fajtorët e “etiketuar” sipas asaj që u

akuzuan në një sistem tjetër, një sistem ku dhunimi i të drejtave të tyre u bë edhe në forma nga më denigrueset. Duhet të theksohet se ai sistem jo vetëm që mohoi të drejtat dhe liritë, por synoi edhe përdhosjen e personalitetit, deri edhe në zhdukjen fizike, si një formë tjetër e dhunshme e trajtimit të qënies njerëzore.

Shoqëritë demokratike dhe shteti i së drejtës u sigurojnë qytetarëve të tyre jo vetëm një respektim të të drejtave dhe lirive të tyre, por edhe mundësinë për të nderuar dhe për të përkujtuar të afërmit dhe njerëzit e tyre të dashur, të cilët mund të jenë persekutuar, internuar, torturuar dhe vrarë (në shumë raste edhe zhdukur në mënyrë të qëllimshme). Si rrjedhojë, në këtë shoqëri, nuk ka se si të bashkëjetojë kujtimi i viktimave nga njëra anë dhe nderimi i figurave që ishin elita komuniste, përkrahës të asaj idelogjie apo persona që kryen krime. Edhe pse pretendohet që nismat ligjore për të ndaluar përdorimin e simboleve komuniste, mund të sjellin një cënim të të drejtave për t'u shprehur, duhet të kuptohet që respektimi i të drejtave të njeriut në këtë rast duhet të bëhet mbi bazë të prevalimit të asaj që është më e rëndësishme në një shoqëri. Në këtë rast, mbrojtja e rendit publik prevalon, dhe andaj ndalimi i përdorimit të simboleve të komunizmit, përkujtimit të ditëve të shënuara, vendosja e emrave të rrugëve, lagjeve, shesheve etj., nuk duhet të lejohet, pasi në vlerësimin tonë do të konsiderohej si një shtypje rishtazi dhe fyerje ndaj kujtimit të viktimave.

Cilësia e një shoqërie demokratike cenohet haptazi nga përkujtimi dhe nderimi i një regjimi që ka shkelur në mënyrë masive dhe të dhunshme të drejtat e njeriut dhe lejimi i kryerjes së këtyre veprimeve do të jepte panoramën e një shoqërie që vazhdon të mos reflektojë mbi të shkuarën dhe pasojat e saj.

Në një shtet demokratik, qytetarët kanë të drejtë të kujtojnë, duke përfshirë të drejtën për të mbajtur zi dhe për të përkujtuar. Ndërkohë që ata vuajnë nga kujtesa e gjallë e një regjimi shtypës, përdorimi i simboleve apo emrave, i jep një kuptim tjetër regjimeve gjenocidale. Duhet të pranojmë që komunizmi solli shumë pasoja dhe përkujtimi i tij nëpërmjet formave me të cilat pretendohet, i minimizon pasojat e tij dhe synon glorifikimin e tij nga ata që e kërkojnë. Duhet të jemi të vëmendshëm që simbolet komuniste duhet të hiqen dhe nuk duhet të përdoren, aq më pak për emërtime, pasi ka të ngjarë që do të nxisin urrejtje, frikë dhe ndarje, duke shërbyer kështu si nxitës i pakënaqësive dhe konflikteve të reja sociale në vendin tonë, i cili ende po vuan nën darën e tranzicionit.

Tashmë edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg ka interpretuar dhe elaboruar përdorimin e simboleve të ndryshme të të kaluarës, në kuadër të mbrojtjes të të drejtës së shprehjes, me qëllim të përcaktimit sa më të saktë e të qartë të kuadrit dhe kufijve të përdorimit të tyre.

Kështu në çështjen *Vajnai v. Hungary*, Gjykata Europiane, pavarësisht nga fakti se gjeti shkelje të nenit 10 të KEDNJ, ka interpretuar ndër të tjera se: “Gjykata është sigurisht e vetëdijshme se terrori sistematik i aplikuar për të konsoliduar sundimin komunist në disa vende, mbetet një plagë serioze në mendjen dhe zemrën e Evropës. Gjykata pranon se shfaqja e një simboli që ishte i kudondodhur gjatë sundimit të atyre regjimeve mund të krijojë shqetësim midis viktimave të kaluara dhe të afërmeve të tyre, të cilët me të drejtë mund t'i konsiderojnë shfaqje të tilla si mungesë respekti”.

Në analizë të fakteve të mësipërme, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon mirëkuptimin dhe trajtimin e kësaj çështjeje me ndjeshmërinë e duhur nga ana juaj në kuadër të respektimit dhe vlerësimit që duhet të ketë shoqëria dhe strukturat shtetërore në të gjitha nivelet për vuajtjet dhe dhimbjet që kanë kaluar një shtresë e caktuar e shoqërisë tonë, duke shmangur përdorimin dhe emërtimin e ambienteve dhe segmenteve publike sipas datave apo simboleve që lidhen me regjimin komunist.

Për të gjitha arsyet që parashtruam, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime, si dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar", në të cilin thuhet se: "Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

### REKOMANDOJMË

- Marrjen e masave të nevojshme për shmangien e përdorimit dhe emërtimit të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e rregjimit komunist.
- Marrjen e masave për verifikimin dhe evidentimin e rasteve të përdorimit të tyre, propozimin dhe fillimin e procedurave për ndryshimin e emërtimeve që lidhen me të kaluarën e rregjimit komunist.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar me Ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005, ku thuhet se;

*"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim.*

*Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ",*

kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**